



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 50

Prishtinë, me 01.02.2017, në ora:13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Xhevahire Izmaqu, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Zenun Pajaziti, Agim Kikaj, Shqipe Pantina, Lahi Brahimaj dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Jelena Bontiq.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësuesi i institutit GAP, NDI, KTV.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Xhevahire Izmaqu, kryetare e Komisionit, me këtë

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Prezantimi i Projektit të Institutit GAP për mbështetje në punën e Komisionit, për vitin 2017;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Prezantimi i Projektit të Institutit GAP për mbështetje në punën e Komisionit, për vitin 2017

Kryetarja e Komisionit e njoftoi komisionin që Instituti GAP ka shprehur interesimin që të mbështet komisionin në fushën e vetëqeverisjes lokale dhe ka ftuar në mbledhje përfaqësuesin e Institutit GAP për të prezantuar projektet për mbështetje të komisionit.

Visar Rushiti, përfaqësues i GAP, njoftoi komisionin për projektet e Institutit GAP, ndër të cilat është edhe vetëqeverisja lokale, lidhur me këtë tha se gjatë aktiviteteve punuese në zbatimin e ligjeve kanë vërejtur dallime, paqartësi, për çështje të caktuara, në ligje, në mes ligjeve apo edhe në aktet nënligjore. Pas identifikimit të paqartësive në mes ligjeve për çështje të caktuara, ia kemi paraqitur kërkesën komisionit për përkrashje me projekt që në periudhën maj - qershor të bëhet një hulumtim për identifikimin e problemeve që dalin nga mos definimi i çështjeve të caktuara me ligj.

Pjesë e projektit sipas tij do të ishte edhe mbajtja e dëgjimeve publike, si dhe monitorimi i zbatimit të Ligjit për vetëqeverisje lokale, veçanërisht neni 17 i ligjit, interpretimit të dyanshëm të dispozitave ligjore, mospërputhja e dispozitave në mes ligjeve, në mënyrë që pastaj komisioni të vendosë për nevojën e plotësim - ndryshimit të ligjit.

Shqipe Pantina, duke u pajtuar me propozim projektin e Institutit GAP, pyeti se çfarë janë objektivat e GAP-it për vitin 2017 për komisionin, në kontekst të mosduplikimit të aktiviteteve nga organizata të ndryshme të çështjeve të njëjta.

Zafir Berisha, tha se defektet dhe problemet që po na përcjellin që nga viti 2008, është vetë miratimi i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në procedurën e atëhershme të përshpejtuar si pjesë e ligjeve të Pakos së Ahtisarit.

Duke e mbështetur projektin, ai kërkoi që aktivitetet të përshpejtohen në kuptimin e kohës domethënë para muajit qershor.

Kujtim Paçaku, kërkoi që pjesë e projektit të jetë çështja e mosndarjes së buxhetit nga vet komunat për të riatdhesuarit, si dhe çështjen e menaxhimit të lagjeve të komuniteteve të tjera, me shërbime të infrastrukturës.

Agim Kikaj, tha se, projekti është një hulumtim që do të konstatojë një gjendje në linjën ekzistuese në hierarkinë e ligjeve dhe që si rezultat do të nxjerrim një konkluzion nga puna e përbashkët.

Lahi Brahimaj tha se, ka një dallim në mes komunave në pikëpamjen e ndarjes së buxhetit, granteve, në forma jo të barabarta duke i dhënë përparësi disa komunave.

Visar Rushiti përkrashje propozimin e komisionit që projekti të implementohet më herët, sipas vullnetit të komisionit.

3. Të ndryshme

Kryetarja e komisionit, njoftoi komisionin për disa paqartësi në plotësim - ndryshimin e Ligjit për RTK-në, të cilat duhet të harmonizohen e pastaj të radhiten në draft -tekstin dhe për të cilat propozoi të takohet grupi punues i komisionit, i cili ka punuar në plotësim -ndryshimin e ligjit për RTK-në.

Konstatim: Komisioni unanimisht vendosi që në përbërje të plotë të vazhdojë harmonizimin e plotësim- ndryshimeve, për arsye se grupi punues ka përfunduar punën dhe i ka prezantuar komisionit plotësim-ndryshimet në Ligjin për RTK-në.

Sadri Ferati, në cilësinë e nënkryetarit të komisionit, i njoftoi anëtarët e komisionit për një takim që kishin pasur me Ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë për çështjet në interes të komisionit.

Shqipe Pantina, kërkoi sqarim rreth miratimit të raportit të punës së komisionit për vitin 2016, pa u diskutuar në komision. Për këtë çështje ajo tha se do t'i drejtohet Kryesisë së Kuvendit me ankesë.

Zafir Berisha, propozoi që kërkesa e tij, e përsëritur disa herë, rreth shqyrtimit të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për disa anëtarë të bordeve, që bien në fushëveprimin e komisionit të radhitet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës.

Konstatim: Komisioni miratoi propozimin, që për mbledhjen e radhës të diskutohet për çështjen në fjalë.

Mbledhja përfundoi në orën: 14:00.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Xhevahire Izmaku